



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT / MUNICIPALITY OF DECAN / OPŠTINA DEČANI

Në bazë të nenit 7. Paragrafi 1. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Neni 9. paragrafi 1. të Statutit të komunës së Deçanit, dhe Vendimit të Kuvendit Komunal të Deçanit 01 Nr.IX-5 të datës 31.10.2019, Komisioni për ndryshimin e Stëmës së Komunës së Deçanit shpall:

**KONKURS
PËR DIZAJNIMIN E STEMËS SË KOMUNËS SË DEÇANIT**

1. Të drejtë pjesëmarrje në konkurs kanë të gjithë personat fizikë dhe juridik , rezident dhe jo rezident të Republikës së Kosovës, e të cilët nuk janë anëtarë të komisionit për ndryshimin e stemës apo komisionit profesional për përzgjedhjen e punimeve më të mira, apo që këto komisione i kanë angazhuar në punën e tyre.
2. Propozimi për zgjidhje ideore të Stëmës së Komunës së Deçanit, duhet që në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dhe Statutin e Komunës së Deçanit të iu përgjigjet karakteristikave historike, kulturore, natyrore dhe karakteristikave tjera të Komunës së Deçanit. Propozimi nuk mundë të ketë formë të njëjte apo të modifikuar me simbolet Shtetërorë dhe nacionale të Kosovës apo të shteteve tjera, me logot e partive politike, shoqërive tregtare, institucioneve, subjekteve tjera juridike dhe organizatave.
3. Kriteret e përgjithshme për hartimin e zgjidhjes ideore të Stëmës :
Stema duhet të jetë e punuar në harmoni me praktikën e zakonshme heraldike dhe të i përgjigjet përmbajtjes nga pika 2. e Konkursit;
 - a. Numri, paraqitja dhe përmbajtja e fushave në modelin e propozuar të Stëmës duhet të jetë e përshtatshme për praktiken heraldike,
 - b. Stema duhet të punohet në dy variante; themelore (e ashtuquajtura stema e vogël) dhe të zgjeruar respektivisht zyrtare (e ashtuquajtur stema e mesme),
 - c. Stema themelore duhet të përmbajë "MBUROJËN" si një element esencial heraldik dhe një simbol tradicional të mbrojtjes,
 - ç. Renditja dhe përmbajtja e fushave në mburojë duhet të plotësojnë kushtet e praktikës heraldike dhe përmbajtja e tyre duhet të përputhet me kërkesat nga pika 2 e konkursit,
 - d. Stema e zgjeruar -zyrtare duhet të ketë mbishkrimin me tekstin Deçani

dh. Trajta dhe forma e stemës duhet të mundësojë teknikën e printimit në disa ngjyra dhe që stema, si simbol, mund të përdoret për punimin e pllakave, diplomave, shenjave, mirënjohjeve publike, suvenireve dhe të ngjashme,

4. Kushtet e veçanta

- a. Vizatimet që paraqesin propozimin për Stemë duhet të bëhen me ngjyra dhe të paraqiten në fletë të veçanta të formatit A4,
- b. Secila nga fletët që përmban propozimet duhet të jetë e shënuar individualisht me një kod dhe një numër,
- c. Në fletë të veçantë të formatit A4 duhet të dorëzohet varianti “bardh-zi” i të njëjtës zgjidhje,
- ç. Në fletë të veçantë të formatit A4 duhet të dorëzohen shembuj të detajuar me aplikimin e stemës së propozuar në memorandume, zarfe postare dhe kartë vizita,
- d. Teknika e bërjes së propozimit mund të jetë edhe me dorë por me ngjyrë (teknikat: dush, temper, bojëra uji, ose një kombinim i këtyre teknikave),
- dh. Përveç dorëzimit të vizatimeve në letër, propozimi paraqitet edhe në formë elektronike në CD në mënyrë që kodi dhe numri i vizatimeve të shënohen në vetë CD-në dhe në paketimin e saj.
- d. Me vizatime është e domosdoshme të bashkëngjitet një përshkrim tekstual se çka përfaqëson secila ngjyrë apo secili detaj i Stemës.

5. Afati i dorëzimit të propozimeve, zgjedhja e tyre dhe shpërblimet:

- a. Punimet dorëzohen në pako (zarfe A4) me KOD, më së largëti deri në ora 16.00 të ditës së fundit të konkursit në adresën; **Komuna e Deçanit, rr. Jashar Salihu nr 3, 51000 Deçan**, me mbishkrimin; **KONKURSI PËR DIZAJNIMIN E STEMËS SË KOMUNËS SË DEÇANIT- MOS E HAP**,
- b. Me punim, në zarf të veçantë të mbyllur është e nevojshme të dorëzohen edhe të dhënat personale të pjesëmarrësve (emri dhe mbiemri, adresa e banimit dhe numri i telefonit) si dhe deklaratën e nënshkruar të autorit që nëse ai shpërblehet, e drejta e autorit transferohet automatikisht tek Komuna e Deçanit dhe se propozimi i ofruar është krijim personal i autorit,
- c. Konkursi zgjatë **30 ditë** nga dita e publikimit të tij. Nëse dita e fundit e konkursit bien në ditë të vikendit ose festave zyrtare, afati i konkursit është dita e parë e punës pas vikendit ose festës zyrtare,
- ç. Pas përfundimit të konkursit, komisioni profesional me procesverbal do të shqyrtoj të gjitha propozimet e arritura dhe do të bëjë përzgjedhjen brenda 7 ditëve dhe për këtë do të informojë pjesëmarrësit e shpërblyer me shkrim.

- d. Tri zgjidhjet ideore më të suksesshme do të shpërblehen. Shpërblimet përfshijnë kompensimin për punë, mjetet materiale të investuara dhe transferimin e të drejtës së autorit Komunës së Deçanit.

6. Shpërblimet janë si vijon:

Shpërblimi i parë 1500 €,

Shpërblimi i dytë 800 €.

Shpërblimi i tretë 500 €.

7. Kushtet e konkursit

- a. Çdo pjesëmarrës i konkursit mund të marrë pjesë me më së shumti tri punime. Çdo punim duhet të dorëzohet Komisionit si dërgesë (punim) e veçantë dhe me kod të veçantë dhe përmbajtje të kërkuar,
- b. Punimet të cilat mbërrijnë pas skadimit të afatit prej 30 ditëve nga dita e publikimit të konkursit nuk do të shqyrtohen,
- c. Propozimet e pa kompletuara sipas konstatimit të komisionit nuk do të shqyrtohen.

Informatat shtesë mund të merren në e-mail adresën: bashkim.ramosaj@rks-gov.net

